ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **QENDRA KLIN.STOMATOLOGJIKE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **220/70900-25-10791-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me Material Dezinfektues**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**BORA DENTAL SH.P.K.**
NUI	**810022971**
Adresa	**Rr.Bernice e Eperme**
Vendi	**Prishtine**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**+38349588892**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Taulant Gashi**
Adresa elektronike	**taulant.gashi@bora-dental.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**10.11.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me Material Dezinfektues

Aktiviteti i prokurimit "Furnizim me Material Dezinfektues", nr. 220/70900-25-10791-1-2-1, zhvillohet nga Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës (QKSUK) me procedurë të hapur, vlerë e mesme, për lidhjen e një kontrate publike kornizë me një operator ekonomik për 24 muaj, e pandarë në lote. Vlera e parashikuar: 60,000.00 €. Kriteri për dhënie të kontratës: tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Njoftimi për Kontratë (B05) është publikuar më 26.11.2025 në platformën e-Prokurimi. Tenderët janë hapur më 16.12.2025, në orën 12:00, përmes e-Prokurimit. Njoftimi i parë mbi Vendimin e AK-së (B58) është publikuar më 13.02.2026 dhe është anuluar me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0108 dhe 2026/0114 të datës 15.04.2026, me të cilin lënda është kthyer në rivlerësim.

Pas rivlerësimit të datës 13.10.2026, AK ka publikuar më 23.10.2026 Njoftimin e ri mbi Vendimin e AK-së (B58), me të cilin për kontratë rekomandohet Medical Group SH.P.K. (54,334.28 €), ndërsa Bora Dental SH.P.K. (54,393.28 €) shpallet e pasuksesshme për shkak të çmimit. Kërkesa për Rishqyrtim e datës 27.10.2026 është refuzuar si e pabazuar me vendimin e ZPP-së të datës 02.11.2026. Njoftimi për dhënie të kontratës nuk është publikuar.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒ **Jo ☐**

Hapja e tenderëve është zhvilluar më 16.12.2025, në orën 12:00, përmes sistemit e-Prokurimi. Sipas procesverbalit të hapjes, janë hapur dhe regjistruar ofertat e katër operatorëve ekonomikë: Matkos Pharm SH.P.K. me 47,318.00 €, Medical Group SH.P.K. me 54,334.28 €, Bora Dental SH.P.K. me 54,393.28 € dhe Grupi i OE-ve Universal Pro SH.P.K., Emma Group SH.P.K. dhe Delta HealthCare SH.P.K. me 58,840.70 €.

Pas hapjes, ofertat i janë nënshtruar ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit nga AK. Vlerësimi i parë (B58 i datës 13.02.2026) është anuluar me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0108 dhe 2026/0114 të datës 15.04.2026. Konsiderojmë se rivlerësimi i datës 13.10.2026 nuk është kryer në përputhje me atë vendim, sepse operatori i rekomanduar për kontratë nuk i përmbush të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, sipas gjetjeve të ekspertit teknik dhe raportit perfundimtar te bordit të OSHP-së për pozicionet 1 dhe 5.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Po. Më 27.10.2026, brenda afatit ligjor sipas nenit 108/A të LPP-së, Bora Dental SH.P.K. ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së (B58) të datës 23.10.2026. Me vendimin e datës 02.11.2026, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit e ka refuzuar kërkesën si të pabazuar dhe ka lënë në fuqi B58-n e datës 23.10.2026, pa trajtuar pretendimet tona për përgjegjshmërinë e ofertës së Medical Group SH.P.K. në pozicionet 1 dhe 5. Kërkesa për Rishqyrtim dhe vendimi i AK-së i bashkëngjiten kësaj ankese.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues, gjatë rivlerësimit të datës 13.10.2026, me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së (B58) të datës 23.10.2026 dhe me vendimin e datës 02.11.2026 për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, ka shkelur këto dispozita të LPP-së:

1. Neni 7 – Barazia në trajtim dhe transparenca: AK nuk ka zbatuar të njëjtin standard vlerësimi ndaj ofertuesve dhe nuk e ka arsyetuar në mënyrë të verifikueshme trajtimin e gjetjeve të OSHP-së.

2. Neni 28, paragrafi 6 – Specifikimet teknike dhe ekuivalenca: pranimi i një zgjidhjeje ekuivalente duhet të mbështetet në prova të përmbushjes së kërkesës funksionale, të cilat për pozicionet 1 dhe 5 të ofertës së rekomanduar mungojnë.

3. Neni 59, paragrafët 1, 2 dhe 4 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve: oferta e Medical Group SH.P.K. është shpallur e përgjegjshme pa u arsyetuar tejkalimi i mospërputhjeve të konstatuara nga eksperti teknik i OSHP-së.

4. Neni 60, paragrafi 1.1 – Kriteret për dhënien e kontratës: çmimi më i ulët është përcaktues vetëm ndër tenderët e përgjegjshëm.

5. Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve: vendimi i datës 02.11.2026 nuk trajton asnjë nga pretendimet e Kërkesës për Rishqyrtim dhe nuk është i arsyetuar.

6. Neni 131 – Mosrespektimi i vendimit të OSHP-së: rivlerësimi nuk është kryer në përputhje me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0108 dhe 2026/0114 të datës 15.04.2026 dhe me gjetjet e ekspertizave të pranuara nga Paneli Shqyrtues.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

BORA DENTAL SH.P.K. kundërshton Njoftimin mbi Vendimin e AK-së (B58) të datës 23.10.2026 dhe vendimin e ZPP-së të datës 02.11.2026 për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, në aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Material Dezinfektues", nr. 220/70900-25-10791-1-2-1. Rivlerësimi i datës 13.10.2026 nuk e ka zbatuar Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0108 dhe 2026/0114 të datës 15.04.2026. Ankuesi mbetet pranë pretendimeve, fakteve dhe bazës juridike të Kërkesës për Rishqyrtim të datës 27.10.2026, të cilat AK nuk i ka trajtuar.

PRETENDIMI 1: Medical Group SH.P.K. mbetet i papërgjegjshëm në pozicionet 1 dhe 5, sipas vetë Vendimit të OSHP-së

AK e ka shpallur Medical Group të përgjegjshëm në rivlerësim, megjithëse Vendimi i OSHP-së ia ka aprovuar ankesën vetëm pjesërisht dhe ka lënë në fuqi dy arsye të eliminimit.

Pozicioni 1 (solucion për pastrim dhe dezinfektim manual të instrumenteve). Në vlerësimin e parë AK ka konstatuar: "Nuk është ofruar produkt konform kërkesave të DT, është ofruar Pre-Desinfectant" (Vendimi i OSHP-së, faqe 12). Eksperti teknik i OSHP-së, në raportin nr. 2026/0114, e ka vërtetuar këtë konstatim. Sipas tij, produkti i ofruar është i destinuar kryesisht për pastrim dhe para-dezinfektim, pra për fazën paraprake të përpunimit të instrumenteve. Eksperti përfundon se arsyetimi i AK-së për eliminim "mbështetet në elemente teknike të dokumentuara" dhe se pretendimi i Medical Group për këtë pikë "vlerësohet i pabazuar" (faqe 17).

Ky përfundim lidhet me funksionin e produktit, jo me emërtimin tregtar apo me një ndryshim formal në përbërje. Për të njëjtin pozicion, eksperti e ka pranuar argumentin funksional të Bora Dental: surfaktantët e produktit tonë "realizojnë funksionin pastrues dhe antimikrobik të kërkuar" dhe pretendimi ynë "vlerësohet i bazuar" (faqe 14). Pra, ekspertiza ka dalluar qartë ndërmjet dy ofertave për pozicionin 1.

Pozicioni 5 (solucion alkoolik për dezinfektim të lëkurës). Dosja e tenderit kërkon efekt të qëndrueshëm deri në 3 orë. AK ka konstatuar: "Mungon efekti i qëndrueshmërisë së produktit të ofruar" (faqe 13). Eksperti teknik ka konstatuar se në dokumentet e produktit nuk evidentohet në mënyrë të qartë se produkti siguron efekt të qëndrueshëm deri në 3 orë në lëkurë, siç kërkohet në specifikimet teknike (faqe 18). Kërkesa e dosjes, pra, nuk është dëshmuar e përmbushur.

Qëndrimi i Panelit Shqyrtues. Paneli i ka pranuar gjetjet e dy ekspertëve si "të pranueshme" (faqe 19). Ankesën e Bora Dental e ka aprovuar "si e bazuar" (faqe 19), ndërsa atë të Medical Group vetëm "si pjesërisht e bazuar" (faqe 20). AK-në e ka obliguar që gjatë rivlerësimit të veprojë në plotëni me LPP-në dhe me kërkesat e dosjes së tenderit.

Pika 1 e dispozitivit i përmend të dy ankesat si të aprovuara, por dispozitivi lexohet bashkë me arsyetimin. Aprovimi i pjesshëm i ankesës së Medical Group do të thotë vetëm se disa arsye të eliminimit kanë rënë (pozicionet 2, 3, 4 dhe 7). Arsyet për pozicionet 1 dhe 5 kanë mbetur në fuqi.

Çfarë ka bërë AK në rivlerësim. Raporti i datës 13.10.2026 e shënon Medical Group "Në pajtim" për të gjitha kërkesat. Raporti nuk identifikon asnjë dokument dhe asnjë arsyetim teknik që shpjegon si është bërë i përgjegjshëm produkti i pozicionit 1 dhe si është dëshmuar efekti 3-orësh në pozicionin 5. Kolona e raportit për sqarimet e tenderëve është e zbrazët. Nëse megjithatë janë marrë sqarime, ato nuk kanë mundur ta ndryshojnë materialisht ofertën, sipas nenit 59.2 të LPP-së.

Oferta vlerësohet në tërësi. Sipas pikës 2.5 të FDT-së kontrata nuk është e ndarë në lote, prandaj pozicionet janë pjesë e një oferte të vetme. Pikat 3.1–3.2, 28.2 dhe 30.1–30.2 të dosjes e lidhin përgjegjshmërinë me përmbushjen e të gjitha kërkesave. Mospërmbushja e një pozicioni të detyrueshëm e bën tenderin të papërgjegjshëm dhe pranueshmëria e pozicioneve të tjera nuk e kompenson atë. Këtë standard e ka zbatuar vetë AK më 13.02.2026 ndaj të gjithë operatorëve.

PRETENDIMI 2: Ekuivalenca nuk është provuar dhe nuk është zbatuar me të njëjtin standard për të gjithë ofertuesit

Bora Dental nuk e kundërshton pranimin e produkteve ekuivalente. Kërkon që ekuivalenca të provohet për kërkesën përkatëse dhe me të njëjtin standard për të gjithë ofertuesit. Pikat 3.1 dhe 9.1–9.2 (kërkesa 2) të FDT-së kërkojnë deklaratën teknike dhe katalogun e prodhuesit për secilin artikull, ndërsa pikat 21.1–21.2 kërkojnë dokumente që dëshmojnë karakteristikat teknike dhe performuese. Për pozicionet 1 dhe 5 të Medical Group, ekspertiza e OSHP-së ka konstatuar se pikërisht kjo provë mungon.

Raporti i rivlerësimit nuk pasqyron një vlerësim të tillë. Ai i shënon "Në pajtim" të tre operatorët që ishin palë në procedurën e ankesës, përfshirë Grupin Universal Pro, Emma Group dhe Delta HealthCare, për të cilin ekspertiza (faqe 16) kishte konstatuar se "nuk

plotëson kërkesat dhe eliminohet" për shkak të TVSH-së. Kjo dëshmon se komisioni ka krahasuar vetëm çmimet, pa i zbatuar gjetjet e ekspertizave. Një veprim i tillë cenon nenet 7, 28.6 dhe 59 të LPP-së dhe nuk përbën zbatim të Vendimit të OSHP-së.

PRETENDIMI 3: Bora Dental është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët

Pas zbatimit të drejtë të Vendimit të OSHP-së, i vetmi tender i përgjegjshëm është ai i Bora Dental:

- Matkos Pharm SH.P.K., 47,318.00 €: i papërgjegjshëm sipas AK-së, i pakontestuar.
- Medical Group SH.P.K., 54,334.28 €: i papërgjegjshëm për pozicionin 1 (pretendim i pabazuar) dhe pozicionin 5 (efekti 3-orësh i padëshmuar).
- Bora Dental SH.P.K., 54,393.28 €: i përgjegjshëm, ankesa e aprovuar si e bazuar për të gjitha pozicionet.
- Grupi Universal Pro, Emma Group dhe Delta HealthCare, 58,840.70 €: i papërgjegjshëm, lideri jo-deklarues i TVSH-së.

Oferta e Grupit Universal Pro, Emma Group dhe Delta HealthCare është edhe më e shtrenjta ndër të katër ofertat: 58,840.70 €, pra 4,447.42 € më e lartë se oferta e Bora Dental. Pavarësisht nga çështja e TVSH-së, ky grup nuk mund të jetë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Vetë AK, në vendimin e datës 02.11.2026, pranon se oferta e Bora Dental "është e përgjegjshme dhe i përmbush kërkesat e përcaktuara". Edhe letra standarde B46 e trajton ofertën tonë si të pasuksesshme vetëm për shkak të çmimit, pa identifikuar asnjë mangësi teknike. Diferenca me çmimin e Medical Group është vetëm 59.00 €. Sipas nenit 60 të LPP-së, çmimi krahasohet vetëm ndërmjet tenderëve të përgjegjshëm, prandaj kontrata i takon Bora Dental.

PRETENDIMI 4: Vendimi i datës 02.11.2026 është i paarsyetuar

ZPP-ja nuk ka trajtuar asnjë nga pretendimet e Kërkesës për Rishqyrtim. Vendimi thotë vetëm se oferta jonë ka çmim më të lartë dhe ia bashkëngjet raportin e rivlerësimit, pa shpjeguar pse Medical Group konsiderohet i përgjegjshëm.

Vendimi thirret në Vendimin e OSHP-së, sikur OSHP-ja të kishte konstatuar se tenderi ynë nuk ishte ai me çmimin më të ulët ndër tenderët e përgjegjshëm. Një konstatim i tillë nuk gjendet askund në vendimin e 15.04.2026. Një refuzim që nuk u përgjigjet pretendimeve dhe mbështetet në një konstatim që nuk ekziston bie ndesh me nenin 108/A të LPP-së.

KËRKESA DREJTUAR PANELIT SHQYRTUES

Bora Dental SH.P.K. i propozon Panelit Shqyrtues që:

1. Ta aprovojë ankesën si të bazuar.
2. Ta anulojë B58 Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 23.10.2026 dhe vendimin e ZPP-së të datës 02.11.2026.
3. Ta kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, me udhëzim të shprehur që AK t'i zbatojë gjetjet e ekspertizave nr. 2026/0108 dhe 2026/0114: Medical Group SH.P.K. i papërgjegjshëm për pozicionet 1 dhe 5, Grupi Universal Pro, Emma Group dhe Delta HealthCare i papërgjegjshëm për shkak të TVSH-së dhe cmimit me te larte, dhe Bora Dental SH.P.K. tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.
4. Ta angazhojë ekspertin teknik të lëmit për të vërtetuar se oferta e Medical Group për pozicionet 1 dhe 5 nuk ka ndryshuar nga ajo e vlerësuar në raportin nr. 2026/0114.
5. Ta shqyrtojë mosrespektimin e Vendimit të datës 15.04.2026 nga AK, në kuptim të nenit 131 të LPP-së.
6. T'ia kthejë ankuesit tarifën e ankesës, sipas nenit 118 të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Vendimi i kontestuar kërcënon t'i shkaktojë BORA DENTAL SH.P.K. dëme materiale përmes humbjes së kontratës publike kornizë 24-mujore, për të cilën kemi paraqitur tender të përgjegjshëm në vlerë prej 54,393.28 €, dhe humbjes së fitimit të pritshëm nga realizimi i saj. Dëmi përfshin edhe shpenzimet për përgatitjen e ofertës, koston e mbajtjes së sigurisë së tenderit gjatë procedurës së zgjatur, tarifat e dy ankesave në OSHP dhe kostot administrative e ligjore për mbrojtjen e të drejtave tona. Në këtë fazë nuk parashtrojmë kërkesë të veçantë për kompensim dhe e rezervojmë të drejtën për ta kërkuar atë në procedurë përkatëse.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*